



Pranuar / Dorezuar Prilijena / Prodato Received / Delivery	04.03	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICE	1178/2022		1/6	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.48/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.48/2022 të datës 21.01.2022 të parashtruar nga ankuesi

të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat

kundër Vendimit me Nr. Ref:06/2022 të

datës 11.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.48/2022 e datës 21.01.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Ref:06/2022 i datës 11.01.2022 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

### A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kundër Vendimit me Nr. Ref:06/2022 të datës 11.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes përfaqësuesit të tij, më datë 21.01.2022 ka parashtruar ankesë me Nr.Prot: 288/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 25/01/2022, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Më datë 03.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/20.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr. Prot:288/2022 të datës 21.01.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Ref:06/2022 të datës 11.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr. Ref:295/2021 i datës 31.08.2021 i Ministres së MPJD-së; Akt Emërimin e datës 19.02.2021 në emër të ankuesit; Vendimin me Nr. Ref:34/2021 i datës 19.02.2021 i zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin me Nr.108/2020 i datës 01.09.2020 i zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin me Nr. Ref:442/2020 i datës 27.07.2020 të Ministrisë së MPJD-së; Vendimin me Nr. 357/2019 i datës 25.07.2019 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr. 038/2015 i datës 20.10.2015 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr. Ref:384/2013 i datës 05.07.2013 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Autorizimin e datës 12.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25/01/2022, Përgjigjen në ankesë e datës 03.02.2022; Akt Emërimin e datës 11.01.2013 në emër të ankuesit; Marrëveshje për Transferimin e Përhershëm të Nëpunësit civil e datës 31.01.2011.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, konstatohet që ankuesi fillimisht ka qenë i punësuar në Ministrinë e Administratës Publike në pozitën "Zyrtar i Lartë Ligjor", mirëpo sipas Marrëveshjes për Transferimin e Përhershëm të Nëpunësit civil të datës 31.01.2011 e lidhur mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Administratës Publike, ankuesi transferohet në pozitën "Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore" në Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Më datë 11.01.2013 ankuesi me Akt Emërim ka mbajtur pozitën "Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore".

Në bazë të Vendimit me Nr. Ref:384/2013 të datës 05.07.2013 të Ministrit të Punëve të Jashtme, ankuesit i është caktuar grada diplomatike Konsull, duke u caktuar të shërbej në Konsullatën e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës në Nju Jork/SHBA. Me Vendimin me Nr.038/2015 të datës 20.10.2015 të Zëvendëskryeministrit të parë dhe Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ankuesi transferohet në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Budapest/Hungari, ndërsa me Vendimin me Nr. 357/2019 të datës 25.07.2019 të Zëvendëskryeministrit të parë dhe Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ankuesi transferohet në gradë të njëjtë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bangkok/Mbretëria e Tajlandës, mirëpo me Vendimin me Nr. Ref:442/2020 të datës 27.07.2020 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ankuesi

kthehet/tërhiqet nga misioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të bëhet sistemimi dhe caktimi i ankuesit.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 01.09.2020 ka nxjerr Vendim me Nr.108/2020 me të cilin ankuesi sistemohet në pozitën Zëvendës Udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe, ndërsa me Vendimin me Nr. Ref:34/2021 të datës 19.02.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi sistemohet në pozitën Udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe. Bazuar në Vendimin me Nr. Ref:34/2021 të datës 19.02.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 19.02.2021 ka lëshuar Akt Emërim AE.nr.19/2021 për emërimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe.

Me Vendimin me Nr. Ref:295/2021 të datës 31.08.2021 të Zëvendëskryeminstres së parë dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi me gradën diplomatike këshilltar caktohet të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Otavë/Kanada me mandat katër (4) vjeçar.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 11.01.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. Ref:06/2022 me të cilin ka bërë shfuqizimin e Vendimit me Nr. Ref:34/2021 të datës 19.02.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Akt Emërimin me Nr. 19/2021 të datës 19.02.2021, duke theksuar që pas përfundimit të misionit diplomatik do të sistemohet sipas aktit të emërimit nr.050 të datës 11.01.2013 Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore apo në një pozitën ekuivalente me të.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që Vendimi me Nr. Ref:06/2022 i datës 11.01.2022 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse nuk janë zbatuar dispozitat ligjore speciale "lex specialis" për sistemim, transferim dhe gradim të diplomatëve të karrierës në shërbimin e jashtëm dhe ministri; Lëvizjet e stafit nga shërbimi civil në shërbimin diplomatik dhe anasjelltas janë bërë sipas diskrecionit ligjor që ka pasur ministri i MPJ sipas nenit 21 dhe 23 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës; Meqë nuk ka dispozita të veçanta që rregullojnë transferimin respektivisht sistemimin e diplomatëve që kthehen nga shërbimi duhet të vlejnjë dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë; Me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Ref:06/2022 i datës 11.01.2022 është vepruar me standard të dyfishtë sepse ka raste të tjera në ministri dhe nuk janë marrë këso veprimesh.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 4 paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë"*, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar që: *"Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente*

*të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”, mbi bazë të kësaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se sipas Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i është njohur e drejta që me rregulla veçanta të rregulloj mënyrën e transferimit dhe sistemit të nëpunësve civil, mirëpo gjatë shqyrtimit të legjislacionit përkatës i cili rregullon fushëveprimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, konstaton se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka rregulla të veçanta të transferimit apo të sistemit respektivisht lëvizjes së stafit nga shërbimi civil në shërbimin diplomatik dhe anasjelltas.*

Meqenëse nuk ka rregulla të veçanta për çështjet që i ka rregulluar neni 4 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, atëherë deri në rregullimin e kësaj çështje, të zbatueshme janë dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, konstaton që ankuesi para caktimit që të shërbej në misionet diplomatike në Ambasadat e Republikës së Kosovës në Nju Jork, Budapest apo edhe në Bangkok, ka mbajtur pozitën “Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore” sipas Akt Emërimit me afat të pacaktuar, ndërsa pas kthimit respektivisht tërheqjes nga misioni diplomatik të ankuesit, i njëjti fillimisht në mënyrë të përkohshme është sistemuar në pozitën zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe, ndërsa me vonë është sistemuar në mënyrë të përhershme në të njëjtën pozitë, si rrjedhojë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se meqë ankuesi ka mbajtur pozitën “Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore” sipas Akt Emërimit me afat të pacaktuar, në asnjë dispozitë ligjore nuk lejohet që të bëhet sistemi i përkohshëm qoftë edhe për interes të institucionit në një pozitë me gradë më të lartë siç parashihet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”,* dhe nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, i cili përcakton se: *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit”,* sepse në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, i cili përcakton që Drejtori i departamentit, në rast të mungesës, zëvendësohet nga udhëheqësi i divizionit, i caktuar me shkrim nga vetë drejtori apo, në rast pamundësisë shëndetësore, caktohet me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm, në këtë rast nuk ka pasur asnjë bazë ligjore që ankuesi të caktohet zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe.

Lidhur me sistemimin e përhershëm të ankuesit në pozitën Udhëheqësi i Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se arsyetimi që pas kthimit të misionit diplomatik nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Bangkok, ankuesi

transferohet në mënyrë të përhershme në pozitën Udhëheqësi i Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe, është arsyetim pa bazë juridike, sepse meqë ankuesi ka mbajtur pozitën "Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore" sipas Akt Emërimit me afat të pacaktuar të datës 11/01/2013, në asnjë dispozitë ligjore nuk është e lejuar që të nëpunësit civil të sistemohen në mënyrë të përhershme në një pozitë me gradë më të lartë dhe pozitë udhëheqëse, ndërsa në rastin konkret të ankuesi është ngritur në detyrë nga pozita Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore në pozitën Udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe, vetëm me vendim, si rrjedhojë me asnjë normë ligjore nuk është rregulluar që në bazë të diskrecionit nëpunësit civil të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pas kthimit nga misioni diplomatik të sistemohen në çfarëdo pozite që është e lirë coftë ajo edhe në gradë më të lartë.

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 39 paragrafi 3, ka përcaktuar se: *"Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë"*, kurse neni 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar këtyre dispozitave, konstaton se Vendimi me Nr. Ref:34/2021 i datës 19.02.2021 i nxjerr nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për sistemimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Dypalëshe, është nxjerr në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1, nenin 39 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse ankuesi me këtë vendim është ngritur në detyrë pas asnjë procedurë ligjore, rrjedhimisht edhe Akt Emërimi AE.Nr.19/2021 i datës 19.02.2021 është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që rregullon shërbimin civil.

Po ashtu lidhur me Vendimin me Nr. Ref:06/2022 të datës 11.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me të cilin është shfuqizuar Vendimi me Nr. Ref:34/2021 i datës 19.02.2021 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Akt Emërimi me Nr. 19/2021 i datës 19.02.2021, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 dhe nenin 55 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, andaj bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin

18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.48/2022,04/03/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet;**

- ❖ Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- ❖ Arkivit të KPMShCK-së